



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 maj 2020  
Nr. Ref.:RK 1570/20

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI06/20**

Parashtrues

**Migjen Selmani**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së**  
**Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP.nr.95/2019,**  
**të 29 korrikut 2019**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Migjen Selmani, me vendbanim në Prishtinë, (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP.nr.95/2019, i 29 korrikut 2019.
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e lartcekur e ka pranuar më 13 shtator 2019.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ( në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 14 janar 2020, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe më 17 janar 2020 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 24 janar 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj, si dhe njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
9. Më 28 janar 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.
10. Më 13 maj 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Nga shkresat e lëndës rezulton se që nga 26 shkurti 2010, parashtruesi i kërkesës është punësuar si Ekspert i Anti-korrupsionit në Departamentin Special Anti-korrupsion, në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
12. Më 6 janar 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Vendimit nr. 02/151, vendosi të ngritën pagat për shërbyesit civil, në vlerë prej 30 % të pagës bazë.
13. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës së bashku me disa të punësuar të tjerë, që ishin në të njëjtën pozitë dhe në të njëjtin institucion me parashtruesin e kërkesës, u janë drejtuar Ministrisë së Administratës Publike duke kërkuar përfshirjen e tyre në sistemin e pagave, përkatësisht rritjen e pagës në lartësi prej 30 % (në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/151, të 6 janarit 2011).
14. Më 31 gusht 2011, Ministria e Administratës Publike njoftoi parashtruesin e kërkesës se përfshirja në sistemin e pagave me rritje do të bëhet vetëm pasi që Prokuroria Speciale e Kosovës të paraqes një dëshmi me shkrim për ekzistimin e mjeteve të mjaftueshme financiare për një gjë të tillë.
15. Më 8 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës së bashku me të punësuarit e tjerë u ishin drejtuar Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me kërkesë për zbatim të Vendimit nr. 02/151, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 6 janarit 2011.
16. Më 4 mars 2013, Këshilli Prokurorial i Kosovës, me Vendimin KPK/Nr 55/2013, refuzoi kërkesën e tyre me arsyetimin se këta të fundit nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën për rritje të pagës pasi që nuk janë të përfshirë në mënyrë taksative në Vendimin nr. 02/151, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 6 janarit 2011.
17. Më 22 mars 2013, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPSHCK), duke kërkuar anulimin e Vendimit KPK/Nr 55/2013, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, të 4 marsit 2013.
18. Më 22 prill 2013, KPMSHCK, përmes Vendimit nr 1071/2013, refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës ka pagë fikse, jashtë sistemit të pagave të shërbyesve civil të Kosovës, prandaj nuk mund ta gëzojë rritjen prej 30 % të përcaktuar me Vendimin nr. 02/151, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 6 janarit 2011.
19. Më 3 maj 2013, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kontestuar ligjshmërinë e Vendimit nr 1071/2013, të KPMSHCK-së të 22 prillit 2013.

20. Më 7 korrik 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit A.nr.612/2010, aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës duke e anuluar Vendimin nr. 1071/2013, të KPMSHCK-së, të 22 prillit 2013 dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje. Në këtë Aktgjykim të Gjykatës Themelore, ndër të tjera, theksohet se “ *vendimi i kontestuar del se përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat qëndrojnë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative [...] Vendimi i kontestuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij*”.
21. Më 1 shtator 2015, KPMSHCK duke vendosur në rigjykim, përmes Vendimit A/02/388/2015, hodhi poshtë si të palejuar ankesën e parashtruesit duke arsyetuar se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte shteruar mjetet juridike, pasi që i njëjti nuk kishte paraqitur ankesë kundër Vendimit KPK/Nr 55/2013, pranë organit ku është i punësuar, respektivisht në Komisionin e ankesave, të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
22. Më 30 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Vendimit të KPMSHCK-së A/02/388/2015, të 1 shtatorit 2015, duke konsideruar se Vendimi i lartpërmendur përmban të meta të shumta, është i paqartë dhe për më tepër është kundërthënës me arsyetimin e vendimit të KPMSHCK-së të vitit 2013.
23. Më 14 nëntor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit A.nr.1669/15, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në këtë Aktgjykim, ndër të tjera, theksohet se pasi që nuk janë shteruar burimet e brendshme të ankesës, nga ana e parashtruesit kërkesa është e parakohshme. Në këtë Aktgjykim theksohet [...] *Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditësit si në padi po edhe deklarimeve të seancës mirëpo si të tilla të njëjtat nuk mundi të aprovoj si të bazuar në këtë çështje administrative meqë nuk i pa me ndikim në një vendosje tjetër*”.
24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.1669/15, duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe shkelje thelbësore të dispozitave procedurale.
25. Më 18 mars 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit A.A.nr.30/2018, refuzoi si të pabazuar ankesën, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1669/15, e vërtetoi. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit theksoi se qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e konsideron si të rregullt dhe të bazuar në ligj dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë.
26. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur në Gjykatën Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe shkelje thelbësore të dispozitave procedurale.

27. Më 29 korrik 2019, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.95/2019, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke konsideruar se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara sepse nuk ndikojnë në vërtetim të një gjendje tjetër faktike nga ajo se çfarë vërtetoi gjykata e shkallës së dytë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

28. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ.
29. Parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendon se gjykatat e rregullta kanë bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesi i kërkesës nuk ka elaboruar më tej se si ka ardhur deri te shkelja e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë, të cilat vetëm se i ka përmendur në kërkesën e tij.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shfuqizojë vendimin e kontestuar si dhe vendimet e tjera të ndërlidhura me vendimin e kontestuar, dhe kërkoj që çështja të kthehet në rigjykim.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

31. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

33. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

34. Gjykata më tej i referohet edhe rregullit 30 [Llogaritja e periudhës kohore] dhe rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës:

Rregulli 30  
[Llogaritja e periudhës kohore]

*Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë rregullore të punës, llogaritet si më poshtë:  
[...]*

*(3) Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore.*

*(6) Ndryshe, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.*

Rregulli 39  
[Kriteret e pranueshmërisë]

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit 20 efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit.*

35. Gjykata fillimisht i referohet datës së dorëzimit të vendimit përfundimtar të kontestuar nga parashtruesi, si dhe datës së parashtrimit të kërkesës në

Gjykatë, për të vlerësuar nëse parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të caktuar ligjor prej 4 (katër) muajve.

36. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje që vendimi i fundit në rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP.nr.95/2019, i datës 29 korrik 2019.
37. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, deklaroi se vendimin e kontestuar e ka pranuar më 16 shtator 2019, mirëpo këtë fakt nuk e ka dëshmuar me fletëkthesë.
38. Në bazë të fletëkthesës të cilën Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dorëzuar në Gjykatë, në përgjigjen e saj të 28 janarit 2020, vërehet se parashtruesi vendimin e kontestuar e ka pranuar më 13 shtator 2019.
39. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 13 shtator 2019, ndërsa kërkesën në Gjykatë e ka dorëzuar më 14 janar 2020 (ditë e martë), që do të thotë se kërkesa e parashtruesit është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor.
40. Duke u referuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), Gjykata vë në dukje se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe për të parandaluar autoritetet dhe palët e tjera të interesuara që të mbahen në gjendje të pasigurisë për një periudhë më të gjatë kohore (shih rastet e Gjykatës: KI140/13, parashtrues i kërkesës, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24; KI49/18, parashtrues i kërkesës *Ilmi Sopa*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 55; KI109/19, parashtrues i kërkesës *Mehmet Qerimi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 shkurtit 2020, paragrafi 37; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së: *Olivier Gaillard kundër Francës*, nr. 47337/99, të 11 korrikut 2000; *Franz Hofstädter kundër Austrisë*, nr. 25407/94, 12 shtator 2000).
41. Ky afat gjithashtu i mundëson parashtruesit potencial që të shqyrtojë nëse dëshiron të paraqes kërkesë dhe të vendosë për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur (shih rastet e Gjykatës, KI49/18, parashtrues i kërkesës *Ilmi Sopa*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 56; rastin KI109/19, parashtrues i kërkesës *Mehmet Qerimi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 shkurtit 2020, paragrafi 38). Kjo në të njëjtën kohë lehtëson vërtetimin e fakteve të rastit, meqë me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejtë i çështjeve të ngritura bëhet problematik (shih Vendimi i GJEDNJ-së, *Nee kundër Irlandës*, nr. 52787/99, i 30 janarit 2003).
42. Në vij me praktikën gjyqësore të GJEDNJ, Gjykata thekson se kufizimi kohor i afatit për kontrollin kushtetues të ushtruar nga Gjykata paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për hapësirën kohore pas të cilit kontrolli i tillë nuk është më i mundur (shih, *mutatus mutandis*, vendimet e GJEDNJ-së: *Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34979/97, i 25 janarit 2000; *Sabri Güneş kundër Turqisë*, i 29 qershorit 2012, paragrafi 40).

43. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse kërkesa e parashtruesit është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 13 maj 2020, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Bekim Sejdiu



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi